# DËSHMI ARKIVI

**A-435027**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Fermeri shqiptar prodhon speca të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/10/fermeri-shqiptar-prodhon-speca-te-kuq-me-helme-kroacia-gropos-14-7-tone/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 13:13:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 10 shtator 2026, 13:06:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 10 shtator 2026, 13:05:00 UTC → 10 shtator 2026, 13:07:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d6d65a5cea63bfd9abac1625205ad5b1d7211e83d3071e2f8428f8f4ec36feca` |
| TEKSTI | `d6a0ba2342ed4bde75db05295d16e6487c211252553cba8e144a558a62ed06b4` |
| PAMJA | `a853a188eb4b00d9cd6ffa55ec6ce8b83be67e1775f57f7ef68ee72d5307a5a3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5168d07eba0f60f43075d578ec61c3c311285703183880d8c4b526b92c88acea` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `43295783c846dc5a1340005f94dab0469e006a0ad02e731a1e6c6bc1387a088b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5168d07eba0f60f43075d578ec61c3c311285703183880d8c4b526b92c88acea`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Fermeri shqiptar prodhon speca të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë

10/09/2026 15:06




**Kroacia ka asgjësuar 147 kuintalë, ose 14 tonë e 700 kilogramë, speca të kuq me origjinë nga Fieri.**

Vendimi për groposjen e produktit shqiptar erdhi pas rezultateve të analizave, të cilat treguan se specat e kuq kishin ngarkesë të lartë me fungicidin proquinazid, në një nivel prej 0.050 mg/kg.

Sipas të dhënave të sistemit RASFF, prodhimi shqiptar rezultoi i ngarkuar me lëndën aktive proquinazid, ndërkohë që për këtë substancë niveli i lejuar i pranisë në speca është zero.

Proquinazidi, sipas listës së produkteve për mbrojtjen e bimëve të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, tregtohet në Shqipëri me emrin Talendo, me vlefshmëri regjistrimi dhe tregtimi deri në fund të vitit 2028.

Burime për gazetaren Rudina Muça nga Top Channel bëjnë me dije se proquinazidi nuk është i ndaluar për t'u shitur, por përdorimi i tij në mënyrë kategorike nuk lejohet në perime. Lënda aktive proquinazid është e autorizuar për përdorim në kulturat e rrushit, për luftimin e sëmundjeve kërpudhore, veçanërisht të mykut pluhur.

Prania e kësaj substance në specat e kuq ngre dyshime të forta se fermeri shqiptar e ka përdorur një preparat të destinuar për vreshtat në kultivimin e perimeve.

Fermeri, por edhe specialistët apo agronomët që këshillojnë përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, mund të kenë aplikuar një preparat të papërshtatshëm në kulturën e specit. Në përpjekje për të mbrojtur prodhimin dhe për të kapur në kohë tregun, përdorimi i një produkti të gabuar mund të ketë sjellë mbetje të larta të pesticidit në produktin final.

Por kjo nuk është hera e parë që specat shqiptarë përfundojnë në qendër të alarmit të autoriteteve kroate.

Pothuajse e njëjta histori është përsëritur më 7 shtator, kur një sasi tjetër specash me origjinë nga Shqipëria është asgjësuar pasi analizat zbuluan nivel të lartë të pesticidit acetamiprid.

Këtë herë, prodhimi shqiptar kishte kaluar përmes një tregtari maqedonas, i cili, pasi kishte blerë specat nga fermeri shqiptar, tentoi t'i rieksportonte drejt Kroacisë. Sipas informacionit të disponueshëm, tregtari nuk ishte në dijeni të nivelit të pesticideve në produkt.

Ishin kontrollorët e ushqimit në Kroaci ata që zbuluan praninë e lartë të acetamipridit në speca. Si pasojë, autoritetet vendosën që produkti të asgjësohej menjëherë në territorin kroat.

## Kryesore



"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social
14:25

Protesta në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz nis me tensione, banorët hyjnë në ambientet e Bankers Petroleum
08:56

Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin
11:35

"Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit
07:37

Transferimi më i shtrenjtë në historinë e Real Madridit, por Diomande ende nuk ka debutuar si titullar
09:44

## Më të lexuarat

Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V

"Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit"/ Vance: Tarifat nuk mjaftojnë për premtimin e Presidentit

Sot gjyqi në Hagë, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët

Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me "Demokratët Europianë": A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?

Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin

"Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit

Shqipëria e para në rajon për shkencë dhe matematikë, ana tjetër e rezultateve të PISA-s: Gjysma e 15-vjeçarëve nuk arrijnë nivelin bazë

Nisin hetimet për mjeken pas vdekjes së ikonës së muzikës greke, Mazonakis u përkeqësua në klinikën private, zbulohet trajtimi që po bënte

Dy raste të tilla brenda një periudhe të shkurtër ngrenë pikëpyetje serioze për kontrollin e përdorimit të pesticideve në fermat shqiptare dhe për mënyrën se si produktet bujqësore kontrollohen përpara se të dalin në treg apo të eksportohen.

Veprime të tilla duhet të parandalohen në kohë nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e ushqimit dhe sigurinë ushqimore. Inspektorët duhet të garantojnë që në fermat shqiptare të prodhohen produkte të sigurta dhe cilësore, në përputhje me normat e përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe jo produkte me mbetje pesticidesh që mund të përbëjnë rrezik për konsumatorët.

**Top Channel**

**"Gjetja" e shqiptarëve për fshehjen e drogës te lulet, shikoni si janë "transformuar" trëndafilat që bënin transportin nga Kolumbia në Greqi**

**Projektligji i ri në Kuvend/ Subjektet me ndërtime pa leje 6 muaj kohë për vetëdeklarim. Shteti merr përsipër pallatet e lëna përgjysmë**

## Aktualitet »



**Situata me zjarret në vend, 10 vatra aktive, qindra forca dhe mjete në terren**

10/09 14:52




**Vidhnin makinat në Vlorë dhe Orikum, arrestohen dy autorët e dyshuar**

10/09 14:29



**"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social**

10/09 14:25



**Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Kallëzimi në SPAK përfshin 16 degë të Thesarit, kërkohet zbardhja e gjithë zinxhirit të vendimmarrjes**

10/09 14:23



**SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë**

10/09 14:12



**"Shtëpi për 4 mijë çifte të reja", Rama prezanton programin e ri për strehimin social: Do përdoren objektet e konfiskuara, si do të bëhet ndarja për 6 kategoritë**

10/09 14:11

## Kryesore »



**Situata me zjarret në vend, 10 vatra aktive, qindra forca dhe mjete në terren**

10/09 14:52



**Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja**

10/09 14:44



**"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social**

10/09 14:25



**Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Kallëzimi në SPAK përfshin 16 degë të Thesarit, kërkohet zbardhja e gjithë zinxhirit të vendimmarrjes**

10/09 14:23



**SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë**

10/09 14:12



**"Shtëpi për 4 mijë çifte të reja", Rama prezanton programin e ri për strehimin social: Do përdoren objektet e konfiskuara, si do të bëhet ndarja për 6 kategoritë**

10/09 14:11

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News-Një në katër vetë me rrogë minimale. Paga mesatare mbi 92 mijë lekë, rritet edhe në ndërtim



Top News – 'SPAK të hetojë Tigrat e energjisë'. PD: ERE nuk i licencon, KESH u jep 20 mln euro



Top News – 'T'i vëmë fre Inteligjencës Artificiale.' Diskutimet te Ligjet për Konventën Europiane



Top Channel/ Taksat për kullat, Rama: Të ardhurat do shkojnë te Fondi i Strehimit, jo tendera për...




Top Channel/ Skandal me "call-centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!



Top News – 'SPAK të hetojë Tigrat e energjisë'. PD: ERE nuk i licencon, KESH u jep 20 mln euro



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.